



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 290**  
**Lënda: Kujdesi gjatë zhvillimit intrauterin**

PROGRAMI I LËNDËS									
Kujdesi gjatë zhvillimit intrauterin									
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Rezarta Lalo</b> <i>Dr në Shkenca Infermierore</i>							
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	0	0	60	1	106	94	200
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Lëndë karakterizuese							
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti II, Semestri II							
<b>Lloji i lëndës</b>		E detyruar							
<b>Programi i studimit</b>		Bachelor në "Infermieri Mami"							
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 290							
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:rezarta.lalo@univlora.edu.al">rezarta.lalo@univlora.edu.al</a>							

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Është një lëndë që studion faktorët e ndryshëm që ndikojnë në zhvillimin intrauterin, patologjitë e zhvillimit që kërkojnë ndërhyrje kirurgjikale, si dhe problemet psikologjike që mund ta prekin gruan gjatë shtatzanisë. trajton kujdesin infermieror të nevojshëm gjatë zhvillimit fetal që nga momenti i konceptimit deri në lindje. Përfshin trajtimin e tre moduleve:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.Embrionologjia ku trajtohet formimi teorik i te gjitha proceseve dhe ndryshimeve qe nga conceptimi deri ne momentin e lindjes te fetusit,si dhe anomalite e lindura.</li><li>2.Procedurat ne menaxhimin e komplikacioneve gjate lindjes dhe kirurgjine obstetrikale</li><li>3.Shendeti mendor dhe shtatezania, ku trajtohen crregullimet e humorit, depresioni postpartum, psikozat postpartum, teknikat baze te komunikimit dhe te kujdesit infermieror</li></ol>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Te formoje nga ana teorike studentet per ndryshimet qe peson veza prej fertilizimit deri ne fund te zhvillimit fetal.</li><li>• Studentet te njohin anomalite e lindura dhe procedurat diagnostike te ketyre anomalive.</li><li>• Te prezantoje teknikat kirurgjikale dhe procedurat ne komplikacionet gjate lindjes.</li><li>• Te njihen mire metodat farmakologjike dhe jo farmakologjike ne lehtesimin e dhimbjes gjate procedurave instrumentale.</li><li>• Te vleresojne crregullimet e humorit dhe te sistemit nervor gjate shtatezanie ,lindjes dhe postpartum.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

<b>Rezultatet e pritshme</b>	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të njohin mire ndryshimet ne periudhat e ndryshme te zhvillimit intrauterin.</li><li>☞ Të kuptojne,njohin dhe familjarizohen me lindjen instrumentale, abortin me vakum.</li><li>☞ Te kuptojne ,njohin dhe familjarizohen me episiotomine, laceracionet perineale si dhe teknikat e riparimit te tyre.</li><li>☞ Të kene njohuri per identifikimin dhe menaxhimin e crregullimeve te humorit dhe depresionit postpartum</li><li>☞ Te njohin rendesine e sigurimit te mbeshtetjes per grate gjate lindjes, procedurave kirurgjikale, abortit .</li></ul>
------------------------------	---

**KONCEPTET THEMELORE**

1. Embriologjia.
2. Komplikacionet dhe kirurgjia obstetrikale.
3. Psikologjia tek gruaja shtatzënë

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> - Nacionet baze në Embriologji. <i>Nje histori e shkurtër e embriologjiëe, Embriologjia, kufijtë e vjetër dhe të rinj</i>	<i>fq. 7</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 2</b> - Gametogjeneza . Ovogjeneza. Ndryshimet morfologjike <i>Shndërrimi i qelizave germinale në gametet femërore dhe mashkullore</i>	<i>fq.17</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 3</b> - Spermatogjeneza. <i>Ndryshimet morfologjike gjatë maturimit të gameteve</i>	<i>fq.28</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e OBS		Praktikë 4 orë
II.	<b>Tema 4</b> - Cikli ovarial, ndryshimet ciklike uterine <i>Cikli i vezores dhe si ndodh fertilizimi</i>	<i>fq. 36</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 5</b> - Ovulacioni me implantim <i>Korrelacionet klinike, Segmentimi dhe formimi i Blastokistit</i>	<i>fq.43</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 6</b> - Formimi i blastokistit, uterusit në kohën e implantimit <i>Qelizat burimore adulte dhe formimi i zigotave jonormale</i>	<i>fq. 47</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e gjinekologjisë		Praktikë 4 orë
III.	<b>Tema 7</b> - Disku embrional dyshtresor (bilaminar) <i>Java e dytë e zhvillimit, ndryshimet e konsiderueshme në raport me zhvillimin</i>	<i>fq. 50</i>	Leksion 1 orë
		<i>fq.59</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 8</b> - Disku embrional treshtresor (trilaminar) <i>Java e tretë e zhvillimit, formimi i mezodermës dhe endodermës embrionale.</i>	<i>fq. 71</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 9</b> - Periudha embrionale <i>Java e tretë deri javen e tetë e zhvillimit</i>		
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e gjinekologjisë		Praktikë 4 orë
IV.	<b>Tema 10</b> - Periudha fetale. Fetusi dhe placenta <i>Zhvillimi i fetusit, membranat fetale dhe placenta</i>	<i>fq. 94</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Tema 11</b> - Zhvillimi i placentës, ndërtimi dhe roli i saj <i>Struktura e placentës, amnioni dhe kordoni umbelikal</i> <b>Tema 12</b> - Qarkullimi placentar. <i>Anomalitë e placentës, barra me shumë fetuse.</i> <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e OBS	<i>fq.109</i> <i>fq.114</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 4 orë
V.	<b>Tema 13</b> - Sistemi kardiovaskular. <i>Formimi dhe pozicioni i tubit kardiak, anomalitë e procesit të ansës kardiake</i> <b>Tema 14</b> - Qarkullimi fetal. Formimi i seprtit kardiak dhe ventrikular <i>Anomalitë e bashkëlindura, shpeshësia e tyre. Shkaqet, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm</i> <b>Tema 15</b> - Vonesa në zhvillimin intrauterin fetal <i>Sistemi arterial dhe sistemi venoz</i> <b>Praktikë mësimore</b> në maternitet	<i>fq. 173</i> <i>fq. 182</i> <i>fq. 193</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 4 orë
VI.	<b>Tema 16</b> - Principet e përgjithshme të anestezis dhe analgjezisë <i>Cilat janë ndryshimet dhe si përdoren</i> <b>Tema 17</b> - Metodat farmakologjike dhe jo farmakologjike për lehtësimin e dhimbjes. <i>Referimi i dhimbjes dhe përdorimi i medikamenteve dhe metodave lehtësuese</i> <b>Tema 18</b> - Bllokada pudentale <i>Indikacionet dhe masat paraprake, qasja perineale dhe qasja vaginale.</i> <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e gjinekologjisë	<i>fq. 116 S.Sh</i> <i>fq. 32</i> <i>fq. 39</i> <i>(menaxhimi i komplikacione ve te shtatezanise)</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 4 orë
VII.	<b>Tema 19</b> - Bllokada paracervikale. <i>Kujdesi infermjeror masat paraprake, te pacientet që bëjnë bllokadë cervikale, vendi i injeksionit</i> <b>Tema 20</b> - Anestezia subaraknoidale (spinale) <i>Konsiderata të përgjithshme.</i> <b>Tema 21</b> - Lindjet kirurgjikale <i>Operacioni cesarean, anestezia lokale dhe vendi i prerjes.</i> <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e gjinekologjisë	Faqe- C- 22 Faqe- C-29 Faqe-C-39	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 4 orë
II.	<b>Tema 22</b> - Forcepsi obstetrikal. <i>Teknika që përdoret nga personeli mjekësor gjatë aplikimit, vendosja biparietale si aplikimi i vetëm i sigurtë</i> <b>Tema 23</b> - Vakumi ekstraktor. <i>Indikacionet dhe teknika që përdor gjatë aplikimit të kallotës Malmstrom, shenjat orientuese të kafkës së fetusit.</i> <b>Tema 24</b> - Kraniotomia dhe kraniocenteza. <i>Performimi i kafkës, prezantimi cefalik dhe incizioni në formë kryqi, punkcioni i kafkës dhe kujdesi pas procedurës</i> <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e obstetrike-gjinekologjisë	<i>fq 103</i> <i>fq. 113</i> <i>faqe-p- 55</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 4 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
IX.	<b>Tema 25</b> - Epiziotomia. <i>Teknika infermirore, komplikacionet dhe riparimi i tyre.</i> <b>Tema 26</b> - Laceracionet perineale gradet dhe riparimi i tyre. <i>Gradet dhe gabimet e personelit infermijeror në shkaktimet e tyre</i> <b>Tema 27</b> - Riparimet e laceracioneve dhe kujdesi <i>Riparimi sipas grades dhe Kujdesi infermijeror pas procedurës</i>  <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e OBS	<i>fq. 111</i>  <i>fq. 157</i>  <i>fq. 165</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Praktikë 4 orë
	<b>Tema 28</b> - Dilatacion, kyretazh dhe shkollitja manuale e placentës. <i>Teknika e futjes së njëres dorë në vaginë përgjatë kordonit, mbajtja e fundusit</i> <b>Tema 29</b> - Punksioni i duglasit <i>Indikacionet, principet e përgjithshme të kujdesit. Kolpotomia për abcesin pelvik</i> <b>Tema 30</b> - Aborti me vakum. Procedura dhe teknika <i>Indikacionet, mbështetja emocionale dhe kujdesi infermijeror të gratë që kryejnë abort me vakum</i>  <b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e gjinekologjisë	<i>fq. 175</i>  <i>fq.191</i>  <i>fq. 199</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Praktikë 4 orë
XI.	<b>Tema 31</b> - Konceptimi shtatzania dhe shëndeti mendor. <i>Rreziku, ankthi dhe depresioni, ngarjet që shoqërojnë nënën</i> <b>Tema 32</b> - Infertiliteti dhe shëndeti mendor. <i>Ankthi i çifteve për të pasur fëmijë, menaxhimi i situatave</i> <b>Tema 33</b> - Faktorët e riskut për çrregullimet e humorit postpartum. <i>Shkaktarët kryesorë dhe shenjat paralajmëruese.</i>  <b>Praktikë mësimore</b> në maternitet	<i>fq. 206</i>  <i>fq. 209</i>  <i>fq. 217</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Praktikë 4 orë
	<b>Tema 34</b> - Post partum Bluer. <i>Lidhjet me komplikacionet obstetrikale Mbizotërimi i depresionit postpartum dhe psikozës Puerperale, kujdesi</i> <b>Tema 35</b> - Depresioni postpartum. <i>Njohja "DEPRESIONI POSTPARTUM" në gjuhë mjekesore. Përmbledhje e depresionit postpartum. Ndryshimet psikologjike gjatë periudhës postnatale.</i> <b>Tema 36</b> - Psikoza postpartum, kujdesi infermijeror <i>Faktorët që rrisin probabilitetin për t'u prekur nga depresioni. Menaxhimi psikologjik, këshillimi, psikoterapia dhe mbështetja sociale.</i>  <b>Praktikë mësimore</b> në maternitet	<i>fq. 237</i>  <i>fq. 240</i>  <i>fq. 241</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Praktikë 4 orë
II.	<b>Tema 37</b> - Parandalimi i psikozave postpartum. <i>Roli i punonjësve të shëndetësisë në parandalimin e rasteve të psikozave.</i> <b>Tema 38</b> - Teknikat baze të komunikimit te punonjësit shëndetësor <i>Sigurimi i mbështetjes së vazhdueshme psikologjike në gratë me psikoza postpartum.</i> <b>Tema 39</b> - Reagimet emocionale dhe psikologjike <i>Si ti dallojmë ato dhe si të parandalojmë</i>  <b>Praktikë mësimore</b> në Qendrën e Planifikimit Familjar.	<i>fq. 244</i>  <i>fq. 248</i>  <i>fq. 250</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Praktikë 4 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
IV.	<b>Tema 40</b> - Mbështetja psikoemocionale e personelit shëndetësor në sëmundshmerinë amtare. <i>Mënyrat e mundshme të trajtimit të depresionit postpartum</i>	<i>fq. 253</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 41</b> - Teknikat e mbështetjes në vdekshmerinë fetale inutero ose gjatë lindjes. <i>Ndërhyrjet individuale dhe ndërhyrjet e fokusuara në nderveprim</i>	<i>fq. 259</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 42</b> - Teknikat e mbështetjes psikoemocionale në lindjen e bebit me malformacione. <i>Hapat që duhen ndjekur</i>	<i>fq. 262</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në repartin e OBS		Praktikë 4 orë
XV.	<b>Tema 43</b> - Barrat hysterike dhe injorimi i shtatzanisë. <i>Neurozat konversive. Menaxhimi i situatave</i>	<i>fq. 265</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 44</b> - Sëmundja maniako depresive tek gratë shtatëzana. <i>Roli i profesionistëve dhe kujdesi infermjeror</i>	<i>fq. 267</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 45</b> - Shtatzanat me skizofreni kronike, kujdesi infermjeror. <i>Gjurmët e skizofrenisë dhe teknikat për të shmangur stresin e panevojshëm.</i>	<i>fq. 278</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në repartin e OBS - gjinekologjise		Praktikë 4 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE						
<b>FREKUENTIMI:</b>		Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.				
<b>Mënyra e vlerësimit</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	1- 15 leksione	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	16 – 45 leksionet	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vleresim i vazhduar*	Java 14/15	Temat e praktikës	10 pikë	Realizim procedurash në mulazh	Demonstrim procedure
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstronjë në mënyrë periodike teknikat infermiore pranë dhe do të përgatitin një detyrë kursi të cilën do ta dorëzojnë në fund të semestrit. Kjo detyrë do të prezantojë një rast të ndjekur në praktikë.					
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:						



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

<b>LITERATURA</b>	
<b>a. Literatura bazë e detyruar</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. <b>'Embriologjia mjekesore e Langman'</b> perkthyer dhe pershtatur nga prof.dr. Elsa Kone ; prof.dr. Xheladin Ceka ; Dr. Shk. Genci Dedja (Fakulteti i Mjekësisë - UT) Tirane 2013, ISBN 978-9928-05-149-3</li><li>2. <b>"Obstetrika/ Neonatologjia "</b> Orion Gliozheni Fedor Kallajxhi " ISBN 99927-15-47-1</li></ol>
<b>b. Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>o Menaxhimi i Integruar i Shtatezanise dhe Lindjes. (departamenti per shendet riprodhues dhe hulumtime) 2009</li><li>o Maternal and child care' Thompson 2008</li></ul>

<b>VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS</b>	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.